



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:030824
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06211585

K.DH.SH.II.nr.248/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit "Posta e Kosovës" Sh.A., me seli në Prishtinë, rruga "28 Nëntori", të cilën e përfaqëson Avokat Lirim Gashi me seli në Prishtinë, ndaj të paditurit "Tregtia" Sh.p.k., me pronar B.B., me seli në Magjistralen Prishtinë-Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokate Erblina Krasniqi nga Prishtina, me Objekt kontesti lirim prone dhe kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.92/22 të datës 05.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit "Posta e Kosovës" Sh.A., me seli në Prishtinë, rruga "28 Nëntori nr. 4".
- II. **VËRTETOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.92/22 të datës 05.10.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.92/22 të datës 05.10.2023, me aktgjykimin ankimuar, ka vendos si në vijim: Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadi e paditësit "Posta e Kosovës" Sh.A., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të Detyrohet e paditura "TREGTIA" me pronar Bedri Prishtina që ta liroj nga sendet dhe personat ngastrën kadastrale nr.7492, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.308 m², e Cila sipas Certifikatës mbi të drejtën e pronës së paluajtshme, evidentohet në emër të paditësit, dhe gjendet në lagjen "Lakërishta — Dardani" në Prishtinë, si dhe që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj demin material dhe fitimin e humbur në lartësi që do të caktohet me ekspertizë financiare për shkak të pamundësisë se shfrytëzimit të palujtshmërisë, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, duke filluar nga data 25.05.2018, kur edhe është paraqitur kërkesa për lirimin e pronës, e deri në pagesën definitive, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes se aktgjykimi nen kërcënimin e

përmbartimit të detyrueshëm. Detyrohet paditësi që të paditurit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë 208.00 € për përpilimin e përgjigjes në padi dhe nga 270.40 € për pesë seanca të mbajtura në shumën e përgjithshme prej 1,560.00 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurit të parë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ashtu që të prishet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të ankesave dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit Paditësi "Posta e Kosovës" Sh.A., pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë më datën 28.02.2020, ka parashtruar padinë kundër të paditurit "Tregtia" Sh.p.lc., për lirimin e pronës dhe kompensim dëmi, në të cilën ka theksuar se e paditura pa pëlqimin e paditësit dhe pa lejen e organeve komunale ka hyrë në mënyrë të kundërligjshme në posedim faktik të palujtshmërisë duke e vendosur një pjesë të trafos elektrike dhe duke instaluar kanalizimet nëntokësore për banesat kolektive të Bllokut A6 të ndërtuara nga e paditura. Tutje ka shtuar se e paditura ka rregulluar me kuba betoni parkingjet të cilat i shfrytëzon për banoret e Bllokut A6. Paditësi ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Inspeksionit dhe Urbanizmit rreth veprimeve të ndërmarra nga palujtshmëria në një pronë, nëse e paditura ka pasur leje për rregullimin e infrastrukturës së parcelës së paluajtshme nr.7492, Drejtoria e Urbanizmit ka informuar se e paditura ka marrë leje për ndërtimin e objekteve B3,B4,B5 dhe B6 në bllokun A6 të planit rregullues "Lakërishta" të cilat janë ndërtuar në parcelat kadastrale 7200, 7201 , 7662/7, 7662/8 ZK Prishtinë. Në shkresën e datës 18.06.2018 nga Drejtoria e Urbanizmit, se e paditura nuk kishte leje për rregullimin e parcelës nr. 7492, dhe Drejtoria e Inspeksionit nuk kishte ndërmarrë veprime për parandalimin e këtij rregullimi pa lejen e duhur. Me padinë e parashtruar paditësi ka kërkuar lirimin e pronës dhe shpërblimin e dëmit për shkak të shkakimit të dëmit material dhe fitimit të humbur për të cilën propozon ekspertizë financiare.

Në shqyrtim gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit ka deklaruar: qëndrojmë në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe të gjitha parashtrimeve dhe prezantimeve të cilat i kemi paraqitur në këtë çështje gjyqësore, duke theksuar se e paditura në mënyrë të kundërligjshme ka hyrë në posedim faktik të parcelës nr.7492 dhe kërkon lirimin e pronës dhe kompensimin e dëmit. Në përgjigjen e saj në padi, e paditura i shmanget përgjegjësisë duke deklaruar se banesat janë tashmë të shitura dhe se nuk kanë legjitimitet pasiv, duke e hedhur barrën tek pronarët e ri të banesave. Tutje ka shtuar se e paditura indirekt pranon shfrytëzimin e pronës duke theksuar se posedimi i parcelës nga e paditura nuk është kundërshtuar ndonjëherë. Shkresat e lëndës tregojnë se blloku A6 përfshin një pjesë të parcelës së paditësit me sipërfaqe

prej 683 m2 brenda këtij blloku. Në vazhdim deklarom se ekspertiza gjeodezike komfor se në parcelën nr.7492 janë bërë ndërhyrje ku janë shtruar rrugë, parking me kocka dhe stabilimente tjera ndihmëse për bllokun A6. Padiësi ka insistuar që pasi ekspertiza financiare nuk ka arritur të caktojë shkallën e dëmit të kryhen ekspertiza të tjera të ndërtimtarisë për tu vlerësuar dëmi i shkaktuar dhe vlerësimi i fitimit të humbur por e njëjta nuk i është lejuar nga Gjykata me arsyetimin se në momentin e kërkesës është hyre në procedurën e provave. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Në përgjigje në padi si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i te paditurit ka deklaruar se nga provat e administruara në mënyrë të pa kontestueshme është argumentuar fakti se e paditura nuk a fare legjitimitet pasiv në këtë procedurë. Kjo konfirmohet nga ekspertiza e gjeodezisë, e cila ka konstatuar se objektet e paditurit janë të ndërtuara brenda kufijve të pronës së tyre dhe nuk kanë një ndikim negativ ndaj pronës së padiësit. Ekspertiza gjithashtu ka treguar që ngastrat janë përdorur edhe nga palë të treta gjegjësisht KEK është pronar i një dollapi të rrymës e jo e paditura. Tutje ka shtuar se ekspertiza financiare ka konfirmuar se nuk ka pasur asnjë dëm material, ashtu siç ka pretenduar padiësi, dhe, si rrjedhojë, nuk ka asnjë bazë për një pretendim pasuror juridik. Me këto argumente gjatë procesit i autorizuari i te paditurit propozon refuzimin e plotë të kërkesëpadiës së padiësit, duke e vlerësuar te pa mjaftuar dhe te pavlefshme. Ndërsa sa i përket deklaratës së padiësit për prezantimin e provave të reja, i autorizuari i të konsideron se gjatë katër seancave të mbajtura për këtë çështje, padiësi ka pasur të drejtën ligjore për të prezantuar çfarëdo prove, ndryshimi apo zgjerimi të kërkesës së tyre, por që i njëjti në vazhdimësi ka qëndruar dhe ka përsëritur provat e njëjta. Andaj konsideron se edhe sikur të nxirrej ndonjë prove tjetër çështja ndaj të paditurit përsëri do të vërtetohet se e paditura si subjekt juridik nuk ka fare legjitimitet pasiv. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka precizuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padiës së padiësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar I.EK.nr.175/2021 të datës 07.07.2022, me të cilin e ka refuzuar si të bazuar kërkesëpadiën e padiësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga leximi i certifikatës së pronësisë me numër 19-30864 e datës 02.06.2016 dhe certifikatës së pronësisë me numër P-71914059-07492-0 e datës 28.10.2020, lëshuar nga Komuna e Prishtinës, Drejtoria e kadastrit, si dhe kopja e planit bashkangjitur certifikatës, vërtetohet fakti se ngastrat kadastrale me P-71914059-07492-0, evidentohet në emër të padiësit më gjerësisht sikurse në këtë certifikatën pronësore.

Gjykata e shkallës së parë nga me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë gjendjes faktike në këtë qeshje ka angazhuar ekspertin përkatës të gjeodezisë, dhe nga këqyrja në vend nga ana e gjykatës së bashku me ekspertin, si dhe në raportin me shkrim nga ana e ekspertit është konstatuar se në parcelën me numër 7492-0 ZK Prishtinë, me ndërtimin e objekteve kolektive banesore-afariste nuk është prekur kufiri verior i parcelës së padiësit, ndërsa në parcelën kontestuese janë vendosur kuba betoni, rrjet kanalizimi dhe trafo elektrike pa u konstatuar se nga kush janë vendosur të njëjtat. Me qëllim të vërtetimit nëse ka pasur fitim të humbur për këtë

çështje gjykata ka caktuar ekspertin financiar i cili për shkak të mungesës së indikatorëve të matshëm dhe provave nga paditësi nuk ka mundur të konstatoj dëm apo fitim të humbur.

Gjykata vlerësoi dispozitën e nenit 18 paragrafi (I) të Ligjit për Pronësisë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS) ku përcaktohet se "Pronësia është e drejta e tërësishme në një send Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe lë tjerë I 'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga te drejtat e një të treti ndërsa në nenin 93 të LPDTS-së përcaktohet se "*Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit [ë caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi*. Në rastin konkrete me as një provë nuk është vërtetuar se e paditura është duke e shfrytëzuar pranon e paditësit, nga dalja në vend shikim ti gjykatës si dhe nga vlerësimi i ekspertit te gjeodezisë është vërtetuar se në parcelën kontestuese janë të vendosur kuba te betonit, trafo elektrike, kontejner te mbeturinave dhe instalime nëntokësorë të lejuara për vendosje nga Komuna e Prishtinës dhe te njëjtat shfrytëzohen nga të gjithë banorët e lagjes, por që prona kontestuese nuk është e kufizuar, nuk ka pengesa apo forma tjera të cilat do të kishin pamundësuar paditësin në shfrytëzimin e lirë të pronës së tije, ndërlidhur me këtë paditësi vullnetarisht i është drejtuar Komunës së Prishtinës me kërkesë për shpronësimin e kësaj palujtshmerie, nga kjo vërtetohet se paditësi është duke zhvilluar procedure administrative me Komunën e Prishtinës për shpronësimin e të njëjtë. Sa i përket kërkesës për kompensimin e dëmit Gjykata gjeti se në rastin konkret nuk është vërtetuar baza juridike për lirimin e pronës dhe as për shpërblimin e demit. Nisur nga fakti se objekt i kërkesëpadisë është Lirimi i pronës, kompensimi i dëmit dhe fitimi i humbur, meqenëse nuk është provuar se e paditura është duke mbajtur pronën, apo se e njëjta ka ndërmarr veprime për shfrytëzimin e pronës së paditësit, Gjykata ka vlerësuar kushteve ligjore për shpërblimin e demit dhe fitimin humbur, konform dispozitave te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Dukë vlerësuar pretendimet e palëve, gjendjes faktike te vërtetuar më lartë dhe provave te administruara, gjykata ju referua nenit 154 par. 1, të Ligjit mbi Detyrimet (kapitulli: bazat e përgjegjësisë) sipas të cilit "kush i shkakton (tjetrit demin, ka për detyrë ta kompensoj në çoftë se nuk provon se dem i lindur pa fajin e tij", Në kuptim të dispozitës së lartcekur, gjykata gjen se për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e demit sipas fajit, duhet të plotësohen kushtet si në vijim: të shkaktohet dem (veprimi dëmtues), te ekzistojë veprimi i kundërligjshëm, te ekzistojë lidhja kauzale në mes të shkakut dhe pasojës, si dhe të ekzistoj fajin. Në rastin konkret nuk është provuar me asnjë prove qe e paditura ka shkakuar ndonjë dëm ndaj paditëses, Në shkresat e lendes nuk ka pasur prova qe vërtetojnë përgjegjësinë juridike të paditurit me te cilën do te vërtetohej veprimi i kundërligjshëm i të paditurit .

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është mjaft i qartë, në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye edhe për besueshmërinë e mjeteve provuese me të cilat ka vërtetuar faktet kontestuese si dhe ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e kualifikimit të fakteve në raport me normat materialo-juridike të cilat janë zbatuar në rastin konkret. Kronologjia e arsyetimit të vendimit sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë paraqet një përmbajtje koherente, unike dhe logjike për përfundimin ligjor lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë gjendjes faktike në këtë çështje ka angazhuar ekspertin përkatës të gjeodezisë, dhe nga këqyrja në vend nga ana e gjykatës së bashku me ekspertin, si dhe në raportin me shkrim nga ana e ekspertit është konstatuar se në parcelën me numër 7492-0 ZK Prishtinë, me ndërtimin e objekteve kolektive banesore-afariste nuk është prekur kufiri verior i parcelës së paditësit, ndërsa në parcelën kontestuese janë vendosur kuba betoni, rrjet kanalizimi dhe trafo elektrike pa u konstatuar se nga kush janë vendosur të njëjtat. Me qëllim të vërtetimit nëse ka pasur fitim të humbur për këtë çështje gjykata ka caktuar ekspertin financiar i cili për shkak të mungesës se indikatorëve të matshëm dhe provave nga paditësi nuk ka mundur të konstatoj dem apo fitim të humbur.

Kolegji i kësaj gjyqate, në procedurën ankimore, në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke refuzuar si të pabazuar ankesën e përfaqësuesit të paditësit dhe duke vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Kolegji e mbështet ne tersi qëndrimin juridik te gjykatës se shkalles e pare në vështrim te dispozitës se nenit 18 paragrafi (I) të Ligjit për Pronësisë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS) përcaktohet se *"Pronësia është e drejta e tërësishme në një send Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me at.ë të disponojë dhe lë tjetrit t 'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga te drejtat e një të treti"* ndërsa në nenin 93 të LPDTS-së përcaktohet se *"Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi"* Ne rastin konkretë me asnjë provë nuk është vërtetuar se e paditura është duke e shfrytëzuar pronën e paditësit. Nga dalja ne vend shikim ti gjykatës shkalles e pare si dhe nga vlerësimi i ekspertit te gjeodezisë është vërtetuar se në parcelën kontestuese janë të vendosura kuba te betonit, trafo elektrike, kontejner te mbeturinave dhe instalime nëntokësore të lejuara për vendosje nga Komuna e Prishtinës dhe te njëjtat shfrytëzohen nga të gjithë banoret e lagjes, por që prona kontestuese nuk është e kufizuar, nuk ka pengesa apo forma tjera të cilat do të kishin pamundësuar paditësin në shfrytëzimin e lirë të pronës së tije, ndërlidhur me këtë paditësi vullnetarisht i është drejtuar Komunës se Prishtinës me kërkesë për shpronësimin e kësaj paligjshmërie, nga kjo vërtetohet se paditësi është duke zhvilluar procedure administrative me Komunën e Prishtinës për shpronësimin e të njëjtës.

Kolegji vlerëson se aktgjykimi i atakuar ka vendosur drejte edhe sa i përket kërkesës për kompensimin e demit. Ndërsa lidhur me bazën ligjor ete kërkesëpadisë Gjykata gjeti se në rastin konkret nuk është vërtetuar baza juridike për lirimin e pronës dhe as për shpërblimin e demit. Nisur nga fakti se objekt i kërkesëpadisë është Lirimi i pronës, kompensimi i demit dhe fitimi i humbur, meqenëse nuk është provuar se e paditura është duke mbajtur pronën, apo se e njëjta ka ndërmarr veprime për shfrytëzimin e pronës së paditësit.

Kolegji vlerëson se sipas dispozitave ligjor të LMD-së, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e demit duhet të përmbushen kushtet e përgjegjësisë: të ekzistojë përgjegjësia e të paditurit, të ekzistojë fakti dëmtues, lidhja shkakore ndërmjet faktit dëmtues dhe demit të shkaktuar dhe kundërligjshmëria e veprimit më të cilin është shkaktuar dëmi. Obligimi për kompensimin e demit ekziston vetëm në rastet që vërtetohet se dëmi është shkaktuar me fajin e dëmtuesit dhe në qoftë se i dëmtuari ka ndërmarrë veprime(masa) për parandalimin e demit apo për zvogëlimin e tij. Bazuar në dispozita e sipër cekura dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata ka gjetur se, nuk ka ofruar prova për të vërtetuar se ekziston përgjegjësia e të paditurit dhe lidhja shkakore (kauzale) ndërmjet veprimeve të së paditurës dhe demit të pësuar.. Prandaj kolegji konsideron se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjyimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjyimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kolegji i kësaj Gjykate. Në rastin konkret nuk është provuar me asnjë prove qe e paditura ka shkaktuar ndonjë dëm ndaj paditëses, në shkresat e lendes nuk ka pasur prova qe vërtetojnë përgjegjësinë juridike të paditurit me te cilën do te vërtetohej veprimi i kundërligjshëm i të paditurit.

Gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjyimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë mori parasysh pretendimet ankimore tjera të autorizuarit të paditësit edhe sa i përket pretendimit se ka propozuar prova tjera ne fjalën përfundimtare, mirëpo këto pretendime kolegji i refuzon si te pabazuara për arsye se, ne fjalën përfundimtare nuk lejohet propozimi i provave tjera. Faza e propozimit të provave duhet të bëhet gjatë periudhës kur zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes, para se të mbyllet shqyrtimi gjyqësor.

Në fjalën përfundimtare, palët bëjnë përmbledhjen e provave të paraqitura gjatë shqyrtimit dhe japin argumentet e tyre ligjore, duke shpjeguar si mbështeten në provat dhe faktet për të mbështetur pozicionin e tyre. Arsyetimi është se faza e provave ka përfunduar dhe gjykata tashmë ka pranuar ose refuzuar provat e propozuara më parë. Propozimi i provave në këtë fazë do të ishte në kundërshtim me parimet e procedurës, pasi palët dhe gjykata duhet të kenë pasur mundësi të barabarta për të diskutuar provat gjatë shqyrtimit të tyre. Në fjalën përfundimtarë palët paraqesin një përmbyllje të kërkesave të parashtruara gjatë seancë gjyqësore si dhe paraqiten propozimet përfundimtare të palëve në këtë fazë të procedurës, pasi që, në këtë fazë të procedurës-në fjalën përfundimtare si në rastin konkret, gjykata tani me, ka përfunduar edhe me leximin dhe administrimin provave.

Duke marr parasysh të lartcekurat kolegji i kësaj gjykate vlerëson se paditësi nuk ka ofruar argumente relevante me të cilat do të kishte arsyetuar pretendimet e tij se në ndonjë mënyrë ka pasur shkelje të pretenduara në të cilat thirret, përveç se ai është i pakënaqur me rezultatin e procedurës, përkatësisht fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të pretenduara. Kolegji i kësaj gjykate konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj, rrjedhimisht në këtë kuptim gjykata vlerëson se paditësi nuk ka arritur të mbështes me prova pretendimet e tij në padi ashtu siç parashihet me neni 7 par.1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”.*

Drejtë është vendosur edhe në raport me shpenzimet e procedurës i cili vendim është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të autorizuarit të paditësit mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Andaj, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ashtu që ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.248/24, me datë 16.09.2024.

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari,
Ramush Bardiqi